

VENDIM
Nr. 30, datë 18.7.2017

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME BERAT - KUÇOVË

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës- Kanalizime Berat - Kuçovë me:
Drejtues ligjor Refat Harizi,
Drejtues teknik Lulzim Sino.
2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Berat -Kuçovë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:
Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura;
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: bashkia Berat-Kuçovë.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër)-vjeçare.

KRYETARI
Ndriçim Shani